



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË
EVADUARA” PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2023

RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

“MBI AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E PERFORMANCËS
ME TEMË “EFEKTIVITETI I PROCESIT TË CERTIFIKIMIT TË
MATERIALIT MBJELLËS BIMOR (FARA E FIDANË), I PËRDORUR NGA
FERMERËT”, EVADUAR NË GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2023, I
USHTRUAR NË MINISTRINË E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE
INSTITUCIONET E VARËSISË ENTIN SHTETËROR TË FARAVE DHE
FIDANËVE, AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT DHE QENDRAT E
TEKNOLOGJISË DHE TRANSFORMIMIT BUJQËSOR”.

NË SUBJEKTET:

- ✓ **MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**
- ✓ **ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE**
- ✓ **AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT**

Tiranë, prill 2025

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I. 1. Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
I. 2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh.....	3
I. 3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh.....	4
I. 4. Statusi i pranimet të rekomandimeve	4
II. HYRJA	5
II. 1. Objekti i auditimit.....	5
II. 2. Qëllimi i auditimit.....	5
II. 3. Metodologjia e auditimit.....	5
II. 4. Konkluzioni	5
II. 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.....	6
III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	6
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	17
- ANEKS.....	18

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I. 1. Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 1480 prot. datë 12.12.2024 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2023”, ushtroi auditim në 3 subjekte auditimi pjesë e Auditimit të Performancës me temë “Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët”, përkatësisht në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Qendrat e Teknologjisë dhe Transformimit Bujqësor.

Auditimi u krye për periudhën e veprimtarisë 2020-2022 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 219 datë 20.12.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe i janë përcjellë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, me shkresat nr. 444/12 prot. nr. 444/13 prot. dhe nr. 444/11 prot. datë 21.12.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

1. Hartimi i programit (Plani Veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;
2. Realizimi i programit (Plan Veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve Brenda afatit 6 mujor;
3. Statusi i rekomandimeve të lëna, (sa rekomandime janë pranuar nga këto sa janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar).

Në subjektet objekt auditimi është mbajtur Akt-Verifikimi përkatës, i cili është regjistruar përkatësisht në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 8105/1 prot. datë 07.01.2025, Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve me nr. 10 prot. datë 07.01.2025 dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit me nr. 50 datë 07.01.2025.

Gjithashtu subjekteve objekt auditimi i është dërguar projekt raporti përkatës, i cili është nisur përkatësisht në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 1480/5 prot. datë 17.02.2025, Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve me nr. 1480/7 prot. datë 17.02.2025 dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit me nr. 1480/6 prot. datë 17.02.2025.

I. 2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, kanë kthyer përgjigje në KLSH brenda afatit 20 ditor, mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimit ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse si dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 19/1 prot. datë 19.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 444/16, prot. datë 26.01.2024, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 18 prot. datë 16.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 444/15, prot. datë 17.01.2024 dhe Autoriteti Kombëtar i

Ushqimit ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 6467/1 prot. datë 15.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 444/14 prot. datë 16.01.2024 mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimit ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse si dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve.

I. 3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh

Në zbatim të nenit 30, paragrafi 2, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është bërë njoftimi brenda afatit me shkresë nr. 970/6 prot. datë 27.06.2024 informacioni në KLSH protokolluar me tonën nr. 655/207 prot. datë 27.06.2024, mbi ecurinë 6 mujore të zbatimit të rekomandimeve, referuar pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014.

Nga ana e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve është bërë njoftimi brenda afatit me shkresë nr. 206 prot. datë 27.06.2024 informacioni i dërguar në MBZHR dhe i paraqitur në KLSH me shkresë nr. 970/6 prot. datë 27.06.2024, mbi ecurinë 6 mujore të zbatimit të rekomandimeve, referuar pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014.

Nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është bërë njoftimi brenda afatit me shkresën nr. 3349 prot. datë 28.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 444/17 prot. datë 02.07.2024, mbi ecurinë 6 mujore të zbatimit të rekomandimeve, referuar pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014.

I. 4. Statusi i pranimit të rekomandimeve

Sipas shkresave përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit, me nr. 444/12 prot. nr. 444/13 prot. dhe nr. 444/11 prot. datë 21.12.2023, janë rekomanduar gjithsej:

✓ Masa organizative 18 rekomandime

Sa i takon statusit të pranimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi, si dhe në mungesë të informimit dhe raportimit në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimevetë lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	18	17	1

Në Autoriteti Kombëtar i Ushqimit 50/3 datë 27.02.2025;

Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresën 1405/2 datë 17.03.2025;

Në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, me shkresën 385/2 datë 21.03.2025.

Projekt Raporti i auditimit i është dërguar subjekteve të mësipërme me shkresat nr. 1480/5/6/7, datë 17.02.2025.

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në vitin 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot. datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 1480 prot. datë 12.12.2024 “*Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6-mujorin e dytë të vitit 2023*” për Auditimine Performancës me temë “*Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët*”.

Raporti Përfundimtar i shoqëruar me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse i është dërguar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, pëkatësisht me shkresat nr. 444/12 prot., nr. 444/13 prot. dhe nr. 444/11 prot. datë 21.12.2023.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë miratuar me Vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 219 datë 20.12.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. K. S., *përgjegjës grupi*
2. B. A., *anëtar*
3. A. H., *anëtar*

Auditimi ka filluar më, 16.12.2024.

Auditimi ka përfunduar më, 17.01.2025.

II.1. Objekti i auditimit

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresat nr. 444/12 prot., nr. 444/13 prot. dhe nr. 444/11 prot. datë 21.12.2023, për Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët”, të ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

II.2. Qëllimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e auditimit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat nr. 444/12 prot., nr. 444/13 prot. dhe nr. 444/11 prot. datë 21.12.2023, nga 18 (tetëmbëdhjetë) masat e rekomanduara rezultoi se:

- ✓ nuk është pranuar 1 rekomandim ose 5.6% e tyre;
- ✓ janë zbatuar 13 rekomandime ose 72.2% e tyre;
- ✓ gjenden në proces zbatimi 4 rekomandime ose 22.2% e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Pa pranuar	Statusi i zbatimit			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa organizative	17	1	13	-	4	-

✓

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	18	100
2	Pa pranuar	1	5.6
3	Pranuar	17	94.4
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	- Zbatuar Plotësisht	13	72.2
2	- Zbatuar pjesërisht	-	-
3	- Në proces zbatimi	4	22.2
4	- Pa zbatuar	-	-

II.5. Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është rreth 72.2%, për disa nga masat organizative Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit nuk kanë mundur të realizojnë tërësisht. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjekti i audituar për përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Pyetja kryesore: A janë institucionet e menaxhimit të integruar të materialit mbjellës shumëzues bimor (fara e fidanë) në shërbim të fermerëve dhe prodhimit bujqësor?

Pyetja 1.1 A ekziston një kuadër ligjor dhe rregullator i plotë dhe me ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjësi mes aktorëve të përfshirë?

Nën pyetja 1.1.1: A kanë hartuar dhe miratuar institucionet përgjegjëse politika të duhura për menaxhimin dhe inspektimin e procesit të certifikimit të materialit shumëzues mbjellës bimor?

1. Gjetje nga auditimi:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka hartuar Plane Veprimi dhe Monitorimi për përshkrimin e veprimeve (aktivitetet) specifike që duhet të ndërmerreshin për realizimin e SNZHRB 2014-2020, Plane monitorimi për periudhat: afatshkurtër (2014 dhe 2015), afatmesme (2016-2020) dhe për periudhën afatgjatë (pas vitit 2020).

- Në SBZHRP 2021-2027, nuk janë përmendur në mënyrë të drejtpërdrejtë politika ose objektiva konkrete dhe të matshëm për institucionet shtetërore të përfshira në procesin e menaxhimit të testimit të varieteteve dhe certifikimit të materialit shumëzues mbjellës bimor.

- Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve nuk ka pasuruar, përditësuar dhe plotësuar me të gjitha ligjet, ndryshimet e tyre, urdhra e rregullore të institucionit për publikun, faqen e WEB-it kundrejt detyrimit ligjor për informimin e publikut në lidhje me materialin mbjellës shumëzues e bimor.
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve aktualisht mban manualisht regjistrin për prodhimin e materialit mbjellës shumëzues bimor i cili nuk është format i miratuar nga MBZHR.

1.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të përfshijë në Strategjinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitet 2021-2027, objektiva konkretë e me afate të mirë përcaktuara, për menaxhimin, mbrojtjen dhe sigurimin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në mbështetje të prodhimit bujqësor, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021-2027, janë përcaktuar politikat, objektivat e përgjithshëm, objektivat specifikë, nevojat, si dhe plani i masave për të realizuar ato, ku ESHFF, ka një rol të rëndësishëm, pasi gjithçka lidhet me farat dhe fidanet.

Politika 1: Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe i zonave rurale.

Objektivat e përgjithshëm:

- 1. Promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativagroushqimor: Përmirësimi i efektshmërisë dhe prodhimit të qëndrueshëm në fermë, rritja e orientimit drejt tregut të sektorit të agropërpunimit ushqimor, harmonizimi në mënyrë progresive i tij me standardet e BE-së, gjë që do të japë një përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm.*
- 2. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe marrja e masave për zbutjen e efekteve negative, si pasojë e ndryshimeve klimatike: Kontribut i shtuar për kujdesin ndaj mjedisit, përshtatjen dhe zbutjen e efekteve të klimës, mbrojtjen e biodiversitetit dhe të peizazhit.*
- 3. Forcimi i strukturës social-ekonomike të zonave rurale: Promovimi i zhvillimit lokal nëpërmjet përmirësimit të mundësive të punësimit dhe të zhvillimit të biznesit brenda dhe jashtë fermës bujqësore, si dhe përmes iniciativave për zhvillim të territorit të udhëhequra nga komuniteti*

Si do të arrihen:

Përmes:

- Përmirësimit të pozicionit të fermerëve në zinxhirin e vlerës (rritja e konkurrueshmërisë, aplikimi në skema, etj, kërkon inputet e para kryesore që janë farat dhe fidanët e certifikuar);*
- Skemave të cilësisë dhe marketingut të produkteve vendase (për të gjitha produktet e regjistruara bujqësore, kërkesë është fara dhe fidani);*
- Rritjes së granteve për fermerë të rinj (kultivimi kërkon fara dhe fidanë të certifikuar);*
- Përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (testime në varietete të ndryshme);*
- Rritjes së eksporteve (certifikime, testime, analiza laboratorike).*

Qëndrimi i grupit të auditimit. Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i papranuar.**

Nën pyetja 1.1.2: A janë aktet nën ligjore të përditësuara dhe në koherencë me kuadrin ligjor kryesor për menaxhimin e materialit mbjellës bimor?

2. Gjetje nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet përgjegjëse, për menaxhimin dhe inspektimin në fushën e farave dhe fidanëve, operojnë me ligjin për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, i cili ndër vite ka pësuar shtesa dhe ndryshime, ndërsa miratimi i plotë i paketës nënligjore rezultoi i përcaktuar, për shkak të disa ndryshimeve të miratuara dhe riorganizimit të institucioneve përfshirëse në këtë fushë.

-Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në mars të vitit 2023 ka ngritur një grup pune për hartimin e projekt ligjit të ri, por ende nuk ka një produkt konkret.

2.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e plotë të paketës së akteve nënligjore (VKM, urdhra e udhëzime) të zbatimit të ligjit për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në përshtatshmëri edhe me Direktivat e BE-së

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ky rekomandim është pranuar pjesërisht me argumentimin se në raportimin gjashtëmuhorit të dytë të 2024 kemi informuar se projektligji është aktualisht në Këshillin e Ministrave, për miratim dhe me këto ndryshime të gjithë aktet miratuese në zbatim të procesit janë zëvendësuar nga vkm në urdhëra dhe në udhëzime, të cilat do të miratohen brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore.

Në vijim të këtij informacioni konfirmojmë se projektligji u finalizua dhe miratua në Kuvendin e Shqipërisë në seancën e datës 13.3.2025. Rithekojmë se të gjithë aktet miratuese në zbatim të procesit janë parashikuar të miratohen brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore. Nisur nga ky argumentim do të vlerësonim maksimalisht mirëkuptimin tuaj për rishikimin e këtij afati dhe të merret në konsideratë afati brenda një 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore.

Fryma e projektligjit me propozimet e ndryshuara mundëson përshtatjen gjerësisht të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj kanë patur në vëmendje të veçantë rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit që në krye të herës, nga ku kemi përmirësuar dhe përcaktuar qartë institucionet përgjegjëse kontrolluese, certifikuese, mundësinë më efektive të identifikimit të operatorëve të biznesit dhe ofrimin e informacionit në mënyrë transparente për grupet e interesit nga ku ndërmerren hapa konkretë për rregullimin e kësaj fushe.

Qasja e re e këtyre rregullimeve ligjore bën të mundur që fermerët do të kenë mundësinë të përdorin material mbjellës me tregues agronomik më cilësor dhe të sigurt, nëpërmjet rregullimit të prodhimit vendas, si dhe të materialit mbjellës, që importohet duke përbushur detyrimin për temën e audituar mbi “Efektivitetin e procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara dhe fidanë), i përdorur nga fermerët”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.**

Pyetja 2.1: A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë ndaj furnizuesve dhe përdoruesve të materialit mbjellës shumëzues bimor?

Nën pyetja 2.1.1:A janë koordinuar midis tyre institucionet përgjegjëse lidhur me procesin e monitorimit, certifikimit, inspektimit të materialit mbjellës shumëzues bimor?

3. Gjetje nga auditimi:

- Nuk mbahet regjistër nga Sektori i Testimit të Varieteteve ku të evidentohet i gjithë procesi që kalon testimi dhe regjistrimi i varieteteve nga kërkesat për testim e regjistrim, arkëtimi i tarifave, kryerjen e testeve, deri në vendim marrjen e Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve (KVVRKK) për testimet dhe regjistrimet në Katalogun Kombëtar.

- Mungon një rakordim periodik mujor i Sektorit të Testimit të Varieteteve me sektorin e financës në Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve për të ardhurat nga tarifat e testeve, regjistrimeve në Katalogun Kombëtar dhe kontratat e shërbimeve të testimit.

1.1. Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të evidentojë të gjithë procesin që kalon testimi i regjistrimit të varieteteve të reja për fara dhe fidanë, nga kërkesa, kryerja e testeve,

nxjerrja e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve deri në Regjistrimin në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varietetevedhe duke kryer rakordim periodik mujor me degën e financës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

ESHFF ka evidentuar në database të gjithë procesin që kalon testimi dhe regjistrimi i varieteteve të reja për fara dhe fidanë, nga kërkesa, kryerja e testeve, nxjerrja e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Varieteteve deri në Regjistrimin në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve mbi bazë të dokumentacionit të prodhuar për këtë qëllim nga Sektori i Testimit të Varieteteve dhe rakordimit periodik mujor që është bërë dhe vazhdon të bëhet në vijimësi nga ky sektor me Sektorin e Financës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mos përputhje e rregullores së brendshme të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në kundërshtim me VKM nr. 531 datë 13.6.2013 “Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të komisionit të vlerësimit të varieteteve për regjistrim në katalogun kombëtar”, e cila duhet të jetë pjesë integrale e VKM së sipër cituar dhe jo ndryshe nga ajo. Sipas VKM Komisioni duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit ndërsa sipas rregullores duhet të mblidhet 2 herë në vit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në përputhje me ndryshimet ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të rishikojnë hartimin dhe miratimin e një rregulloreje të re “Për organizimin dhe funksionimin e Brendshëm të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve”.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në përputhje me ndryshimet ligjore për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor ka miratuar rregulloren e re “Për organizimin dhe funksionimin e Brendshëm të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve” Nr. 1782/2 prot. datë 17.05.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua, rënie e numrit të regjistrimeve të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar, për periudhën 2020-2022, si pasojë e mos finalizimit të procesit regjistrimit në këtë Katalog për varietetet e reja të testuara nga Enti Shtetëror i Farave e Fidanëve me Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve (KVVRKK) ku nga 157 teste varietetesh për periudhën në auditim janë regjistruar në Katalogun Kombëtar vetëm 41 prej tyre ose 26 % e numrit total çka tregon menaxhim pa efektivitet të burimeve njerëzore si në ESHFF, KVVRKK ashtu edhe për Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në rajone.

4. Gjetje nga auditimi: Nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve për periudhën në auditim, nuk janë regjistruar 116 varietete në Katalogun Kombëtar të specieve dhe varieteteve duke sjellë ulje të të ardhurave dytësore në buxhetin e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve si dhe mos finalizim të procesit të regjistrimit të varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar.

3.1 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të marrë masa për kryerjen e njoftimeve

zyrtare ndaj operatorëve bujqësorë për kryerjen e pagesave të përcaktuara për regjistrimin e varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar, me qëllim pasurimin dhe rifreskimin e tij.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve me urdhrin e brendshëm nr.48 datë 27.12.2023 është nxjerrë lista e subjekteve debitore për të vazhduar me procedurën e regjistrimit dhe me shkresën nr.415 datë 28.12.2023 janë njoftuar subjektet por nuk ka asnjë reagim për të bërë pagesat.

Në vijim të propozimit të bërë për ndryshimin e Udhëzimit nr.5 lidhur me procesin e testimit dhe regjistrimit, nga Ministria është miratuar Udhëzimi nr.26 datë 21.10.2024 me anë të të cilit zgjidhet problemi i kryerjes së pagesave për regjistrim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.**

5. Gjetje nga auditimi: Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve nuk ka të publikuar në faqen e tij zyrtare, Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve si dhe nuk ka kryer procedurat e rifreskimit të të dhënave të këtij katalogu për vitet 2020-2022 me regjistrime dhe çregjistrime të varieteteve. Gjithashtu konstatohet se Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve nuk ka kryer asnjë çregjistrim varieteti për një periudhë prej 26 vite.

5.1 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve/Spektori i Testimit të Varieteteve të marrë masa të menjëhershme për analizimin e çdo varieteti që për shkaqe të tejkalimit të afatit të regjistrimit në Katalogun Kombëtar duhet të çregjistrohen dhe ti paraqesë këto përfundime në Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve për të marrë vendimin përkatës.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Në mbledhjen e KVVRKK-së me vendimin nr.45 dhe nr.84/1 prot. datë 04.03.2024 është miratuar çregjistrimi për disa varietete, ndërsa për varietetet autoktone nuk është miratuar çregjistrimi me argumentin se ato kanë vlera dhe rëndësi ekonomike. Për sa i përket Katalogut Kombëtar, në bashkëpunim me subjektet që janë personat përgjegjës të varieteteve, po punohet për të paraqitur ndryshimet përkatëse dhe do bëhet përditësimi i tij në faqen web: www.eshff.gov.al

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.**

5.2 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve të marrë masa për publikimin në faqen e tij zyrtare të Katalogut Kombëtar të specieve dhe varieteteve si dhe të kryejë përditësimin e tij me regjistrimet e reja dhe çregjistrimet sipas procedurave të mirë përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Publikimi i Katalogut Kombëtar është bërë dhe përditësimi bëhet në vijimësi për çdo regjistrim të varietetit të ri të miratuar me Vendim të KVVRKK-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.**

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022 janë 7,098 hektarë të mbjella me bimë medicinale në Shqipëri (shifër e përafërt me vitet 2020-2021) dhe nuk rezulton asnjë fidan i tillë i certifikuar nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, ndërkohë që për sipërfaqe të përafërta të mbjella për vitet e

mëparshme rezultojnë rreth 78 mln fidanë të certifikuar për vitin 2021 dhe 22,7 mln fidanë të certifikuar për vitin 2020. Për vitet 2020-2022 nuk është certifikuar asnjë material mbjellës dhe shumëzues bimor i luleshtrydhes fasules, duhanit, lulediellit sojës dhe panxhar sheqerit.

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka realizuar një analizë të detajuar në lidhje me sipërfaqet e mbjella me material mbjellës dhe shumëzues bimor të kulturave të luleshtrydhes, fasules, duhanit, lulediellit sojës dhe panxhar sheqerit.

-Nuk janë analizuar importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të tyre, për të vlerësuar sa material mbjellës dhe shumëzues bimor duhet ti nënshtrohet certifikimit nga ana e Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve për vitet 2020-2022 pasi rezulton që nuk është certifikuar asnjë prej këtyre materialeve mbjellës dhe shumëzues bimor.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë të koordinojnë të dhënat në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për të saktësuar, listën e furnizuesve, materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar dhe sipërfaqet e mbjella.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

“AKU ka bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm me DP. Doganave në lidhje me kryerjen e të gjithë procedurave të importit të Materialit Mbjellës dhe Shumëzues Bimor (MMSHB-ve fara/fidanë). Theksojmë faktin se nga ana e autoriteteve doganore nuk kryhet asnjë veprim doganor/procedurë importi të MMSHB-ve pa aktin administrativ të lëshuar nga inspektori fitosanitar të PIK-eve të AKU-së. (do MMSHB importi në RSH shoqërohet me dokumentacionin shoqërues (certifikatë origjine, certifikatë fitosanitare, certifikatë cilësie dhe etikete zyrtare). Nga ana e AKU-së, sektori i Koordinimit të Kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar/KKPIK, (siç kemi informuar grupin auditues të KLSH me dokumentacion faktues), mban të dhëna (sasia, lloji MMSHB-së, destinacion, importuesi, etj) për çdo import të MMSHB-ve, fara dhe fidanë të OB, të dhëna këto të cilat përditësohen çdo ditë për çdo import të kryer. Informacioni mbi importet ditore të MMSHB-ve i dërgohet MBZHR-së në rrugë zyrtare me e-mail çdo ditë në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit. AKU disponon listën e furnizuesve importues të MMSHB-ve (fara dhe fidanë), informacion ky i cili merret nga të dhënat e importeve të kryera çdo ditë në PIK-e.

Sa është shpjeguar më lart rezulton se MBZHR disponon informacion mbi importet e kryera për MMSHB dhe për rrjedhojë listën e furnizuesve importues të MMSHB-ve.

AKU nëpërmjet sistemit elektronik online AKU-net ka parashikuar ndërlidhjen me sistemin ASICYCUDA të autoritetit doganor me qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me import/eksportet për kategoritë e produkteve të cilat janë objekt kontrolli i AKU-së”.

Sistemi AKU-net është i ndërlidhur edhe me sisteme të tjera si QKB, RUDA, LIMS dhe e- inspektim. Kompania që menaxhon sistemin AKU-net ka kryer observimet e tyre që sistemet të ndërveprojnë dhe me sisteme të tjera. Moduli PIK ka përfunduar dhe pritët që të ndërveprojë me sistemin ASYCUDA sistem që përdoret nga Drejtoria e Doganave (kjo e fundit nuk ka kryer procedurat e ndërveprimi) dhe mbas përfundimit do jetë online (live).

AKSHI është përgjegjëse për krijimin dhe investimin e sistemit AKU-net, si institucioni përgjegjës për sistemet dhe ndërveprimin e tyre në Republikën e Shqipërisë.

AKU gjatë kësaj periudhe (periudhës së zbatueshmërisë së rekomandimeve) ka kryer takime online me ndjekësit e sistemit të ASYCUDA, Drejtorisë së Doganës si dhe përfaqësues së AKSHI-it, ku është dakortësuar ndërveprimi midis dy sistemeve (sistemit AKU-net dhe ASYCUDA). AKU bazuar në komunikimin me e-mail datë 18.12.2024 i kërkoi operatorit të ASYCUDA informacion mbi ecurinë e ndërveprimi të sistemeve, gjë për të cilën ende nuk ka marrë një përgjigje. Gjithashtu,

AKU gjatë vitit 2023-2024 ka kryer një sërë komunikimesh zyrtare me e-mail si dhe me shkresa drejtuar IQ dhe AKSHIT, e MBZHR (ne dijeni).

Vazhdon të jetë në proces ndëreveprimi i sistemit ASYCUDA i autoritetit doganor me sistemin AKU-net.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet i **pranuar dhe në proces zbatimi**.

7. Gjetje nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka realizuar një analizë të detajuar në lidhje me sipërfaqet e mbjella me material mbjellës dhe shumëzues bimor të kulturave të luleshtrydhes, fasules, duhanit, lulediellit sojës dhe panxhar sheqerit duke dhënë statistika që nuk garantojnë dhe nuk japin siguri për kontrollin e fidanëve të certifikuar.

-Nuk ka të dhëna konkrete dhe në kohë reale as nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe as nga institucionet e varësisë në lidhje me sasitë e importuara dhe ato të eksportuara të materialit mbjellës shumëzues bimor të tyre, duke krijuar një gjendje konfuzë dhe të pa qartë për garantimin e procesit të certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor i cili ndikon në cilësinë e MMSHB-së.

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural së bashku me strukturat e saj të varësisë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Entin Shtetëror të Farëve dhe Fidanëve nuk kanë arritur të maksimizojnë të ardhurat nga procesi i certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si pasojë e mos koordinimit në kohë në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Entin Shtetëror të Farëve dhe Fidanëve të përditësojnë të dhënat mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar dhe eksportuar për të hartuar dhe realizuar me objektiva të matshëm dhe gjithë përfshirës planin e kontrollit me bazë rrisht për subjektet tregtuese të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

MBZHR ka përditësuar dhe do vazhdoj të përditësuar në vazhdimësi të dhënat mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar dhe eksportuar duke bashkëpunuar me AKU, ESHFF dhe AKVMB për përditësimin e të dhënave për prodhuesit vendas të MMSHB-ve.

AKU siç kemi raportuar grupin e KLSH edhe në raportimet e mëparshme disponon listën e subjekteve importuese të MMSHB-ve (fara dhe fidanë), informacion ky i cili merret nga të dhënat e importeve të kryera çdo ditë në PIK-e informacion që i dërgohet MBZHR mbi importet e kryera çdo ditë për MMSHB-të. Për më tepër nga sektori KKPIK i dërgon drejtorëve rajonale të AKU-së periodikisht informacion ditor mbi importet e MMSHB-ve të cilat kanë destinacion qarkun e tyre.

Gjithashtu, AKU ka bashkëpunuar periodikisht me ESHFF, AKVMB dhe MBZHR kanë shkëmbyer informacion në rrugë zyrtare me e-mail me Qershor 2024, Shtator 2024 për listat e subjekteve prodhuese të MMSHB-së, informacion ky i cili ju është dërguar DRAKU në Korrik 2024 për verifikim dhe janë përditësuar listat e kontrolleve për planin pasardhës.

Të gjithë të dhënat e përditësuara në lidhje furnizuesit që kryejnë aktivitetin e importimit, prodhimin dhe tregtimin të MMSHB disponohen nga AKU, janë shkëmbyer me AKVMB, ESHFF dhe MBZHR, listë e cila është unifikuar dhe hedhur në web e Ministrisë së Bujqësisë, si dhe të gjitha këto të dhëna kanë shërbyer për hartimin e Draft - planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë rrisht për vitin 2025 (i cili është dërguar me shkresë zyrtare Nr. 6067 prot. datë 12.12.2024 për miratim MBZHR si dhe shkresë zyrtare Nr. 5349 datë 23.10.2023 për konfirmim IQ).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

7.2 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të marrë masa dhe të publikojë në web, listën e përditësuar të furnizuesve për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, periodikisht me qëllim garantimin e zinxhirit të procesit të certifikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve ka përditësuar në web, listën e furnizuesve për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, periodikisht me qëllim garantimin e zinxhirit të procesit të certifikimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar**.

7.3 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë të koordinojnë të dhënat në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për të saktësuar, listën e furnizuesve, materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar dhe sipërfaqet e mbjella.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit (AKU) dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, siç trajtohet në pikën 6.1, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

Nën pyetja 2.1.2: A i kanë shërbyer të ardhurat dytësore të krijuara nga ESHFF, AKU, QTTB, përmirësimit të menaxhimit të materialit shumëzues mbjellës bimor?

1. Gjetje nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me strukturat e saj të varësisë Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve nuk kanë arritur të maksimizojnë të ardhurat nga procesi i certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor si pasojë e mos koordinimit në kohë në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të materialit mbjellës dhe bimor.

- Rezultojnë subjekte debitorë në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit për penalitetet e vendosura për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në vlerën 2,810,000 lekë të cilat nuk janë arkëtuar në 3 vite.

1.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve të analizojnë situatën e procesit të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues me qëllim rritjen e të ardhurave.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Është bashkëpunuar me ESHFF, ku janë kryer takime të vazhdueshme me fermerët dhe subjektet prodhuese. Në bashkëpunim me AKSHI-n me shkresën nr.105 prot. datë 19.03.2024 ka grupuar procedurat e aplikimeve me qëllim lehtësimin e procesit të certifikimit. Gjithashtu ka lajmëruar subjektet nëpërmjet e-mailit për kryerjen e procesit të certifikimit për rritjen e numrit të aplikimeve për efekt certifikimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm **konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.**

1.2. Rekomandimi: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrë masa për arkëtimin e gjobave duke ndjekur të gjitha procedurat e mbledhjes së detyrimeve.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Në zbatim të këtij rekomandimi AKU ka marrë masat duke paraqitur në gjykata 136 kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi për vitin 2024, pas konfirmimit të ezaurimit të ankimit administrativ dhe marrjes dijeni nga ana e subjekteve lidhur me vendimmarrjen e Komisionit. Prej tyre 46 kërkesa janë me vendim pranimit për lëshim urdhër ekzekutimi nga gjykata. Janë dërguar për ekzekutim zyrtarë përmbartimore 64 kërkesa për vënie në ekzekutim". Janë arkëtuar në total 244 gjoba në vlerën 33,937,144 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

Nën pyetja 2.1.3:A kanë në dispozicion strukturat e kontrollit dhe inspektimit të AKU, QTTB-ve, ESHFF-së logjistikën e nevojshme dhe burimet njerëzore të mjaftueshme për realizimin e detyrave kontrolluese dhe inspektuese?

1. Gjetja nga auditimi: Në referim të detyrave funksionale sipas rregulloreve të funksionimit të brendshëm të MBZHR, për periudhën 2020-2022, nga auditimi *konstatuam se:*

- Nuk ka pasur struktura dhe detyra funksionale të dedikuara për monitorimin e farave, fidanëve dhe materialin mbjellës dhe shumëzues bimor dhe rrjedhimisht nuk ka as targete të plotësuar në referim të prioriteteve strategjike.

- Sektori i Shëndetit të Mbrojtjes së bimëve dhe OMGJ në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka kryer analiza operacionale periodike për menaxhimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të farave, fidanëve dhe materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në koordinim me institucionet e varësisë (ESHFF, AKU dhe QTTB).

-nuk ka informacion dhe të dhëna reale në lidhje me sasinë e stokut të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor (MBSHB) në magazinat e furnizuesve, nga inspektorët e Pikave të Inspektimit Kufitar (PIK-ut) të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, e cila sjell mungesë të dhënash në të gjithë zinxhirin administrativ të funksionimit të procesit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

-Mungojnë planet për trajnimin e specialistëve në fushën e farave dhe fidanëve për periudhën 2020-2022.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të bashkëpunojë me strukturat e saj inspektuese dhe monitoruese duke konkretizuar veprime me objektiva të matshëm dhe afate të përcaktuara me qëllim evidentimin në kohë të problemeve, rritjen e rolit të saj si institucioni qendror në politikë bërje dhe llogari dhënie.

Në vijimësi

Përgjigja e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

MBZHR ka bashkëpunuar periodikisht në zbatim të këtij rekomandimi me AKU dhe ESHFF.

Siç i është vënë në dispozicion informacioni grupit të kontrollit të KLSH-së dhe jeni bere me dije ne dy raportimet e mëparshme te muajit Janar dhe Qershor 2024, AKU (Sektori KKMBIB) kryen kontrollet zyrtare në bazë të planit të kontrolleve zyrtare me bazë risku dhe marrjes se mostrave të miratuara nga MBZHR si dhe urdhëra të veçantë të Ministrit të Bujqësisë, Drejtorit të Përgjithshëm

etj. Në këto plane është përcaktuar frekuenca e kontrolleve zyrtare si dhe marrja e mostrave që do të kryhet për çdo furnizues e ndarë në muaj.

Nga ana e AKU hartohen raporte periodike për analizat 3, 6, 9 mujore dhe analiza vjetore. Në këto raporte evidentohen ecuria, gjetjet, problematikat e konstatuara gjatë kontrolleve zyrtare, si dhe progreset e veprimtarisë inspektuese të cilat i janë dërguar periodikisht MBZHR ne rruge zyrtare me email dhe shkresore edhe për 6 mujorin e dytë të vitit 2024, dhe janë pasqyruar numri i inspektimeve të kryera, mostrat e marra dhe të analizuara, gjetjet e konstatuara gjatë kontrolleve zyrtare dhe masat administrative të mara ndaj subjekteve që kanë kryer shkelje të dispozitave ligjore në fuqi”.

Gjithashtu, AKU në kuadër bashkëpunimi komunikon edhe me AKVMB-n me qëllim rritjen e efektivitetit të kontrolleve zyrtare në fushën e MMSHB-ve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2. Gjetja nga auditimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Enti Shtetëror i Farave nuk kanë realizuar rekomandimet e UPOV-it, për periudhën 30 gusht 2005- dhjetor 2022 pasi nuk është regjistruar asnjë varietet i ri për të drejtën e seleksionerit në Shqipëri duke mos respektuar bashkëpunimin me këtë organizatë, ku vendi ynë aderon me të drejta të plota.

2.1 Rekomandimi: Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve të marrë masa dhe të rrisë bashkëpunimin me institucionet kërkimore shkencore siç është Universiteti Bujqësor i Tiranës për verifikimin e specieve që plotësojnë kushtet shkencore për njohjen e tyre si varietete të reja për të drejtën e seleksionerit në Shqipëri.

Në vijimësi

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Në kuadër të bashkëpunimit më institucionet kërkimore shkencore ESHFF ka lidhur akt-marrëveshje me Institutin e Resurseve të Bankës Gjendetike (Institucion në varësi të UBT-Tiranë) për testimin e varieteteve të reja me qëllim regjistrimin në KK. Në bashkëpunim me UBT jemi në duke bashkëpunuar për zbatimin e projektit me GIZ për varietetet autoktone.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

3. Gjetja nga auditimi: Për periudhën 2020-2022, në referim të detyrave funksionale sipas rregulloreve të funksionimit të brendshëm dhe sipas organigramës së miratuar, konstatohet se numri i punonjësve të planifikuar të institucionit Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve është me 30% mungesë të burimeve njerëzore në sektorët kryesorë për monitorimin dhe kontrollin e procesit të testimit dhe certifikimit të materialit mbjellës shumëzues bimor.

3.1 Rekomandimi: Entin Shtetëror i Farave dhe Fidanëve në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrin masa të plotësojnë të gjitha vendet bosh në organikën e saj.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe DAP në janar të 2024 ka plotësuar të gjithë pozicionet vakante.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

4. Gjetja nga auditimi: Laboratori Qendror i Testimit të Farave, nuk është i akredituar prej krijimit të tij dhe nuk është ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve asnjë nismë për fillimin e këtij procesi me rëndësi në cilësinë e MMSHB-së.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Entin Shtetëror të farave dhe Fidanëve të marrin masa për akreditimin e Laboratorit Qendror të Farave në mënyrë që analizat e tij të jenë të besueshme edhe të akredituara.

Brenda vitit 2024

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Ky rekomandim është në vijueshmëri, si procedurë gjithëpërfshirëse dhe ka nisur pikërisht me:

- *Kalibrimin e instrumenteve matëse të laboratorit nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë me kërkesën në datën 21.03.2024 dhe kalibruar më datë 06.08.2024.*
- *Kërkesën me email-in fillestar për akreditimin fillestar të Laboratorit në Drejtorinë e Akreditimit më datë 18 shtator 2024.*
- *Krijimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në përputhje me ISO 17025 në vazhdimësi.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

5. Gjetja nga auditimi: Në referim të detyrave funksionale sipas rregulloreve të funksionimit të brendshëm të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, për periudhën 2020-2022, nga auditimi konstatuam se:

- Për vitet 2020 dhe 2021, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve nuk ka hartuar Plane Veprimi për monitorimin e aktiviteteve.
- Nuk ka regjistër apo listë të unifikuar të subjekteve furnizues importues dhe prodhues në vend të materialit mbjellës shumëzues e bimor në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk ka një metodologji tip për hartimin e planit të riskut në përcaktimin e saktë dhe korrekt të subjekteve me risk si dhe mungon bashkëpunimi e roli i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve në këtë planifikim.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Enti Shtetëror i farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të marrin masa në përgatitjen e një listë të unifikuar të subjekteve importues, tregtues dhe prodhues të materialit mbjellës shumëzues e bimor dhe ta publikojnë atë në faqen zyrtare të web-it.

Brenda datës 31.12.2023

Përgjigja e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

Informojmë se ky detyrim është i përmbushur dhe publikuar në faqen zyrtare të MBZHR-së.

“Bazuar në të dhënat për subjektet importues, tregtues dhe prodhues të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të cilët janë vënë në dispozicion nga AKU, është të bërë e mundur publikimi i tyre në faqen zyrtare të webit të MBZHR-së”, në linkun: <https://bujqesia.gov.al/lista-e-produkteve-pleheruese-te-regjistruara-ne-republiken-e-shqiperise/>

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar përgjigjes së subjektit dhe dokumentacionit të shqyrtuar nga grupi i auditimit, rekomandimi i mësipërm konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

IV. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Entin Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, përkatësisht me shkresat nr. 444/12 prot., nr. 444/13 prot. dhe nr. 444/11 prot. datë 21.12.2023, konstatohet se 1 nga 17 rekomandime të lëna nuk është pranuar.

Nga KLSH kërkohet përsheptimi i rekomandimeve në proces zbatimi, trajtuar si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

Nën pyetja 1.1.2: A janë aktet nën ligjore të përditësuara dhe në koherencë me kuadrin ligjor kryesor për menaxhimin e materialit mbjellës bimor?

1.1. Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e plotë të paketës së akteve nënligjore (VKM, urdhra e udhëzime) të zbatimit të ligjit për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor në përshtatshmëri edhe më Direktivat e BE-së

Brenda vitit 2025

Nën pyetja 2.1.1: A janë koordinuar midis tyre institucionet përgjegjëse lidhur me procesin e monitorimit, certifikimit, inspektimit të materialit mbjellës shumëzues bimor?

2.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me institucionet e varësisë të koordinojnë të dhënat në kohë reale me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për importet dhe eksportet e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për të saktësuar, listën e furnizuesve, materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar dhe sipërfaqet e mbjella ((rekomandim i lënë edhe në pikën 7.3 të rekomandimeve).

Menjëherë dhe në vijimësi

Nën pyetja 2.1.2: A i kanë shërbyer të ardhurat dytësore të krijuara nga ESHFF, AKU, QTTB, përmirësimit të menaxhimit të materialit shumëzues mbjellës bimor?

3.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Entin Shtetëror të farave dhe Fidanëve të marrin masa për akreditimin e Laboratorit Qendror të Farave në mënyrë që analizat e tij të jenë të besueshme edhe të akredituara.

Brenda vitit 2025

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin **në proces zbatimi**, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, kërkohet përmbushja e plotë e tyre brenda **vitet 2025**.

Për sa më sipër u mbajt ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Aneksi 1

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Auditim performance me temë : “Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët”

Në 000/lekë

Nr .	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vler a lekë	Nr .	Vler a	Nr .	Vl era	Nr.	Vl era	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr .	Vler a	Nr.	Vlera	Nr .	Vler a	Arkët uar	Mbet ja	Nr .	Vler a	Nr .	Vle ra
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ																				
2	Masa organizative	18	-	17	-	1	-	94.4%	-	13	-	-	-	4	-	-	-	-	-	-	-
3	Masa shpërblim dëmi																				
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
5	Për eliminimin e efekteve																				
6	Masa disiplinore																				
7	Masa Administrative																				
TOTALI		18	-	17	-	1	-	94.4%	-	13	-	-	-	4	-	-	-	-	-	-	-

KLSE